

Shpallje

Termat e Referencës

<u>Organizata</u>	Handikos Ferizaj (Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuar)
<u>Qëllimi i Angazhimit</u>	Qëllimi i angazhimit të ekspertit është të ofrojë mbështetje profesionale për rishikimin, përditësimin, harmonizimin dhe finalizimin e dokumenteve ekzistuese që lidhen me barazinë gjinore, sigurinë në punë dhe standardet higjieno-sanitare të organizatës. Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit “Grant Institucional EJA- GI- 15” , i mbështetur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’ dhe bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia .
<u>Tipi</u>	Individuale/ Kompani
<u>Lokacioni</u>	Ferizaj, Kosovë
<u>Kohëzgjatja</u>	3 ditë

Handikos Ferizaj

Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara Handikos-Ferizaj, punon për të arritur njohjen dhe pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në shoqëri si dhe aktivisht lobon dhe mbron në nivel lokal të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i përgjithshëm

Qëllimi i angazhimit është rishikimi dhe përditësimi i dokumenteve ekzistuese në fushën e barazisë gjinore, sigurisë në punë dhe standardeve higjieno-sanitare, me synim përshtatjen e tyre me nevojat aktuale të organizatës dhe krijimin e procedurave dhe standardeve të qarta për zbatim në praktikë.

Një (1) Ekspert/e lokal;

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Shqyrtimi dhe analiza e dokumenteve ekzistuese;
- Identifikimi i nevojave për ndryshime, plotësime dhe përditësime;
- Zhvillimi i punëtorisë me stafin;
- Mbledhja dhe integrimi i komenteve dhe rekomandimeve;
- Rishikimi dhe përditësimi i Rregullores për Barazi Gjinore;
- Rishikimi dhe përditësimi i Rregullores për Siguri në Punë;
- Përgatitja dhe përcaktimi i standardeve higjieno-sanitare;
- Përgatitja dhe finalizimi i manualit për zbatimin e standardeve;
- Dorëzimi i versioneve finale dhe të konsoliduara të dokumenteve.

Kualifikimet dhe eksperiencia

- Diplomë universitare në drejtësi, administratë publike, menaxhim, shkenca sociale, siguri në punë, shëndet publik ose fusha të ngjashme;
- Përvojë profesionale në hartimin, rishikimin dhe përditësimin e rregulloreve, politikave dhe dokumenteve institucionale;

- Njohuri dhe përvojë në fushën e barazisë gjinore dhe sigurisë në punë;
- Përvojë në zhvillimin e standardeve, procedurave dhe manualeve të brendshme;
- Përvojë në punën me organizata joqeveritare dhe/ose organizata të shoqërisë civile konsiderohet përparësi;
- Përvojë në zhvillimin e punëtorive dhe konsultimeve me staf;
- Aftësi të mira analitike, komunikuese dhe përgatitëse të dokumenteve.

Kohëzgjatja dhe pritjet

Angazhimi do të realizohet brenda **3 ditëve të punës**, ku një ditë do t'i kushtohet zhvillimit të punëtorisë fizike me stafin e Handikos Ferizaj, ndërsa dy ditë do t'i kushtohen rishikimit, përditësimit, harmonizimit dhe finalizimit të rregulloreve ekzistuese. Nga eksperti/ekspertja pritët përfundimi dhe dorëzimi i versioneve të përditësuara dhe të konsoliduara të dokumenteve, në përputhje me nevojat dhe rekomandimet e dakorduara gjatë punëtorisë.

Aplikuesit duhet të dorëzojnë

- Draft-propozim mbi metodologjinë e punës, duke përfshirë edhe koston financiare të kalkular për ditët e angazhimit.
- Letër interesi, që shpjegon arsyet pse aplikuesi/ja është i/e përshtatshëm/e dhe evidenton njohuritë dhe eksperiencën relevante në fusha të ngjashme.
- Curriculum Vitae (CV) e detajuar, duke përfshirë përvojën profesionale dhe arsimore.

Pagesa

Pagesa për Ekspert/e, do të bëhet sipas përfundimit të përgjegjësisë të kontraktuar;

Procedurat e aplikimit:

Aplikacionet duhet të dorëzohen vetëm në formë elektronike në adresën e-mail:

prokurimihandikos@gmail.com, me subjektin: "Aplikoj për [emri i pozitës që aplikoni]".

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është **04.09.2026 ora 23:59**

Vetëm kandidatët që përzgjidhen për listën e ngushtë do të kontaktohen. Gjatë gjithë procesit, informacione të mëtejshme nuk ofrohen përmes telefonit.

